



01/Nr.3349/2025

Në mbështetje të neneve 12, 16, 17 dhe 40 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neni 4 i Ligjit Nr. 03/L-049 – Për Financat e Pushtetit Lokal, neni 43, 65, Statuti i Komunës së Hanit të Elezit, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.05.2025 merr:

VENDIM

PËR RITJEN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT NGA TEJKALIMI I PROJEKSIONIT TË TË HYRAVE VETANAKE PËR VITIN 2025

1. Miratohet kërkesa me **Nr.04/3349/2025** për ritjen e buxhetit nga tejkalimi i projeksionit të të hyrave vetanake për vitin 2025. Projektioni i të hyrave vetanake komunale për vitin 2025 është në shumë prej 339,719.00 €, inkasimi deri në muajin Prill është në shumë prej 430,232.29 €. Tejkalimi i projeksionit të të hyrave vetanake deri në muajin prill është në shumë prej 90,513.29 €.

2. Mjetet nga neni 1 i këtij vendimi planifikohen të destinohen si vijon:

Në kategorinë buxhetore **Mallra dhe Shërbime**, shuma prej 46,713.29 €, në kuadër të :
Zyra e Kryetarit (16035), kodi funksional (0111), në shumë prej 10,000.00 €,

Zyra e Kuvendit Komunal (16935), kodi funksional (0111), në shumë prej 2,000.00 €,

Administrata (16335), kodi funksional (0133), në shumë prej 10,000.00 €,

Buxhetimi (17535), kodi funksional (0112), në shumë prej 2,000.00 €,

Parandalimi dhe Inspektimi i Zjarrit (18444), kodi funksional (0320), shuma prej 4,713.29 €,

Shërbimet e Shëndetësisë Primare (75050), kodi funksional (0721), shuma prej 18,000.00 €.

Në kategorinë buxhetore **Shpenzime Komunale**, shuma prej 3,500.00 €, në kuadër të:

Shërbimet Kulturore (85035), kodi funksional (0820), shuma prej **3,500.00 €**.

Në kategorinë buxhetore Shpenzime Kapitale, shuma prej 40,300.00 €, në kuadër të:
Planifikimi Urban dhe Inspekcioni (66480), kodi funksional (0620), në shumë prej **40,300.00 €**,
në këto projekte:

- “Shtrimi me kubëza betoni të rrugicave dhe trotuareve në Han të Elezit dhe fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Dimçë, Pustenik, Gorancë, Dermjak, Rezhancë, Krivenik” me kod (53471), në shumë prej **10,000.00 €**.
 - “Rregullimi i varrezave të qytetit dhe fshatrat Gorancë, Pustenik dhe Rezhancë” me kod (55039), në shumë prej **23,000.00 €**.
 - “Ndërtimi i mureve mbrojtëse në Lagja e Re dhe në fshatrat Paldenicë, Dermjak, Pustenik, Seçishtë, Gorancë, Krivenik, Dimçë” (52894), në shumë prej **7,300.00 €**.
3. Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës

Hani i Elezit
Data: 29. 05. 2025





01/Nr. 3348/2025

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 neni 11,12,40, Ligji mbi ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 Nr.08/L-332 neni 16 paragrafi 6 dhe 9, Statuti i Komunës së Hanit të Elezit neni 65, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.05.2025 merr:

VENDIM

PËR FUTJEN E PROJEKTIT TË RI KAPITAL "NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I PARKINGUT NË AFËRSI TË XHAMISË NË FSHATIN PALDENICË" NË KUADËR TË BUXHETIT PËR VITIN FISKAL 2025

1. Miratohet kërkesa Nr.04/3348/2025 për futjen e projektit të ri "Ndërtimi dhe Rregullimi i Parkingut në Afërsi të Xhamisë në fshatin Paldenicë" në kuadër të Buxhetit për vitin fiskal 2025.
2. Duke ju referuar nenit (1) të këtij vendimi, projekti është rezultat i konsultimeve me qytetarët dhe është vlerësuar si i nevojshëm për ta implementuar me qëllim të përmirësimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm në komunitet, si dhe në përputhje me prioritetet zhvillimore të Komunës së Hanit të Elezit.
3. Ky projekt do të destinohet në:
 - Nën-Programi Buxhetor: Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66480),
 - Kategoria e Shpenzimeve: Investime Kapitale (300),
 - Burimi i fondit: Të hyrat Vetanake Komunale (21).
4. Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtja e Mjedisit,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës

Hani i Elezit
Data: 29. 05. 2025

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.3954/2025

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 12, 40, 82.2, Ligji Nr.05L-031- për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 53, duke vepruar sipas Kërkesës së MPL-së Nr.1943-2/25 të datës 30.04.2025, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.05.2025 merr:

V E N D I M
PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT ME NUMËR 01/ Nr. 948/2025

1. Shfuqizohet Vendimi i Kuvendi të Komunës 01/Nr.948/2025 i datës 27.02.2025 për Planin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt.
2. Vendimi për shfuqizimin e vendimit të përcaktuar si në pikën 1 të këtij vendimi bëhet pas kërkesës së MPL-së të datës 30.04.2025 respektivisht konfirmimit të ligjshmërisë nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës.
3. Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Ministria e Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 29. 05. 2025

